



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 13, Datë 29.01.2024

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.217, DATË 20.12.2019,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SH.A. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MIVAS”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1940 KW**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 5/1 prot., datë 22.01.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Mivas” me kapacitet të instaluar 1940 kW”.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 217, datë 20.12.2019, ka vendosur të licencojë shoqërinë “ELVA 2001” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, për një afat 30-vjeçar me kusht që shoqëria të depozitohet në ERE, çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumenta/leje.
- Në kuadër të plotësimit të kushtit për depozitim të lejes së rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor ERE ka zhvilluar korrespondencë me AMBU-në për informacion në lidhje me rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor për Hec “Mivas” nga subjekti “ELVA 2001” sh.a. AMBU me shkresën nr. 1928/3 prot., datë 18.10.2023, ka konfirmuar se leja është miratuar nga Këshilli i Basenit Ujqor Seman në mbledhjen e datës 05.10.2023.
- Me shkresën nr. 1928/5 prot., datë 26.10.2023, ERE i kërkoi shoqërisë të depozitohet lejen e rinovuar, me shkresën nr. 1929/7 prot., datë 03.11.2023, shoqëria depozitoi lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor me nr. Serie 000130, nr.1038 prot., datë 10.10.2023, të miratuar me vendimin nr. 25, datë 05.10.2023, të Këshillit të Basenit Ujqor Seman për përdorim të

burimit ujon sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik nga Hec “Mivas”, me afat një 5-vjeçar, **me afat vlefshmërie deri më 05.10.2028.**

- Me depozitim të këtij dokumenti, duhet të ndryshohet dispozitivi i vendimit nr. 217, datë 20.12.2019, duke qënë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që të shtohet pika 3, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujon sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik nga Hec “Mivas” brenda datës 05.10.2028, po ashtu të shtohet dhe pika 4 me përmbajtje: *nëse subjekti nuk e depoziton këtë leje brenda afatit të përcaktuar dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.*
- Gjithashtu në kuadër të plotësimit të kushteve dhe dokumentacionit që i nënshtrohet rinovimit është kontrata me Bashkinë Skrapar. Si e tillë ERE ka vijuar komunikimin me shoqërinë me shkresën nr.1928/9 prot., datë 14.11.2023 ku i kërkoi shoqërisë “ELVA 2001” sh.a. të depozitohet kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Skrapar.
- Shoqëria me shkresën nr. 1928/12 prot., datë 22.11.2023 ka depozituar kronologjinë e kontratave të rinovuara me Bashkinë Skrapar: *Kontratën e qirasë me nr.2786 prot., datë 06.10.2021 e lidhur mes shoqërisë “ELVA 2001”sha dhe Bashkisë Skrapar “Për dhënie në përdorim të tokës (kullotë) pa frut”, me një afat 3 (tre) vjeçar duke filluar nga data 16.07.2020 deri në 16.07.2023, në vijim me shkresën nr.5 prot., datë 03.01.2023) dhe Kontratën e qirasë me nr.3353 prot., datë 21.12.2023 e lidhur mes shoqërisë “ELVA 2001”sha dhe Bashkisë Skrapar “Për dhënie në përdorim të tokës (kullotë) pa frut”, me afat 3(tre) vjeçar duke filluar nga data 16.07.2023 deri në 16.07.2026.*
- Në lidhje me kontratën e qirasë me Bashkinë Gramsh nr.7262 prot., datë 18.10.2017 e lidhur mes shoqërisë “ELVA 2001”sh.a. dhe Bashkisë Gramsh “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullor publik”, me afat 10 (dhjetë) vjeçar, rezultojnë **e vlefshme deri në datë 25.03.2029.**
- Me depozitim të kontratës me Bashkinë Skrapar e cila nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë, gjithashtu dhe kontrata me Bashkinë Gramsh nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë, si e tillë vlerësojmë që në dispozitivin e vendimit të ndryshojë përcaktimi i pikës 2, ku të përcaktohet se shoqëria duhet të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar me Bashkinë Gramsh “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullor publik”, **brenda datës 25.03.2029, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti,** dhe kontratën me Bashkinë Skrapar “Për dhënie në përdorim të tokës (kullotë) pa frut”, **brenda datës 16.07.2026, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.**
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019, ndryshon dhe bëhet:
 2. Shoqëria “ELVA 2001” sh.a. duhet të depozitojë në ERE:
 - a) Kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Gramsh brenda datës 25.03.2029, ose Certifikatën e Lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon te drejtën e përdorimit të pronës në zone ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.
 - b) Kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Skrapar brenda datës 16.07.2026, ose Certifikatën e Lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon te drejtën e përdorimit të pronës në zone ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.
2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:
 3. Shoqëria “ELVA 2001” sh.a. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “MIVAS” brenda datës 05.10.2028.
3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:
 4. Në rast se shoqëria “ELVA 2001” sh.a. nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq, sikurse përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrijë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë:
5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit të kushteve të tij.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ELVA 2001” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI